



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

MBI PJESËMARRJEN E SHQIPËRISË NË KONKURSIN NDËRKOMBËTAR TË VIZATIMIT 2018/2019 “WORLDWIDE WOMEN LEADERS MONACO”

Shoqata “*Femmes Leaders Mondials Monaco*”, mbështetur nga Princi i Monakos, organizon në Monako Edicionin e I të Konkursit Ndërkombëtar të Vizatimit 2018/2019 me temë "Ruaj Zemrën e Grave".

Mbajtja e këtij konkursi ndërkombëtar ka si synim kryesor luftën kundër sëmundjeve kardiovaskulare si dhe inkurajon barazinë ndërmjet burrave dhe grave në trajtimin e këtyre sëmundjeve. Për këtë arsye Shoqata Femmes Leaders Mondials Monaco, ka hartuar një konventë, e cila synon të vendosë marrëdhëniet midis një shkolle arti ose çdo institucioni tjetër që merr pjesë në këtë konkurs me shoqatën “Femmes Leaders Mondiales Monaco”.

Në kuadër të kësaj konvente vetëm një shkollë e një vendi pjesëmarrës ka të drejtë të marrë pjesë me një kandidat, i cili do të prezantojë një vizatim të vetëm që do të sugjerojë shkolla. Vizatimi i përzgjedhur duhet të miratohet nga një juri profesionale e vendit nga i cili vjen kandidati. Në përfundim të këtij konkursi ndërkombëtar në muajin prill 2019 do të mbahet edhe një mbrëmje Gala, në të cilën ftohen të marrin pjesë studentët e përzgjedhur të shoqëruar nga profesorët e tyre. Për sa më sipër inkurajohet pjesëmarrja e nxënësve dhe studentëve të profilit të kërkuar për këtë konkurs. Kandidatët pjesëmarrës duhet të jenë mbi moshën 16 vjeç.

Për një informacion më të detajuar për mënyrën e aplikimit dhe kushteve që duhet të plotësojë aplikanti, ju lutemi referojuni materialit informativ bashkëlidhur i cili gjendet gjithashtu në adresën web:

www.femmesleadersmondialesmonaco.mc

<http://oia.ym.edu.të/attachments/article/1445/%E7%B0%A1%E7%AB%A0.pdf>

Afati i fundit për dorëzimin e vizatimeve pranë kësaj shoqate është data **30 tetor 2018** dhe gjendet në adresën e mëposhtme:

Association Femmes Leaders Monaco

Madam Chantal RAVERA

Présidente

FEMMES LEADERS MONDIALE MONACO –

37, boulevard du Larvotto –

«Le Testimonio» -

98000 MONACO –

DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS